



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 30746 Prot.

Tiranë më, 30.12/2016

UDHËZIM

Nr. 11 datë 30.12 2016

Bazuar në ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 102/2014 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, të gazit dhe nenprodukteve të tyre" i ndryshuar, VKM-në nr. 612, datë 5.9.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit 'Për akcizat' i ndryshuar", Drejtori i Përgjithshëm :

URDHËZON:

1. Strukturat përgjegjëse në qendër dhe në zyrat doganore në zbatim të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar", dhe VKM 612 datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit të akcizës" të ndryshuara, duke filluar nga data 29 Dhjetor 2016, të marrin masa për:
  - evidentimin e subjekteve tregëtuese të produktit "Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh",
  - njoftimin e subjekteve tregëtuese me shumicë (sh.a) dhe të tregëtimit me pakicë, të produktit "Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh", për detyrimin për të depozituar stokun e produktit, në mbyllje të dates 31.12.2016.
2. Duke filluar nga data 1 janar 2017, asnjë subjekt i tregëtimit me pakicë, nuk do të lejohet të kryejë blerje të produktit "Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh", pa paguar më parë detyrimet e akcizës.
3. Duke filluar nga data 1 janar 2017, subjektet e tregëtimit me shumicë të produktit "Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor

- automjetesh*", nuk do të lejohet të shesin produkt pa paguar më pare detyrimet e akcizës.
4. Në rast të evidentimit të subjekteve tregëtuese të produktit "*Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh*" të cilët nuk kanë depozituar stokun në mbyllje të dates 31.12.2016, do t'ju bllokohet aktiviteti deri në përmbushjen e kushtëzimeve ligjore.
  5. Në rast të evidentimit të subjektet e tregëtimit me pakicë, të produktit "*Gaz i naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh*" ,të cilët pas datës 1 Janar 2017 kryejnë blerje dhe shitje të këtij produkti pa paguar detyrimet e akcizës, do t'ju bllokohet aktiviteti perms procesverbaleve të bllokimit dhe plumbosjes.
  6. Subjektet e evidentuara dhe të bllokuara, do të ndiqen në vijimësi nga degët doganore mbikqyrëse sipas ligjit 61/2012"*Për akcizat në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar*".
  7. Në rast të plotësimit të kushtëzimeve ligjore nga ana e subjekteve të bllokuara, autoritetet doganore menjëherë marrin masa për ç'bllokimin e aktivitetit dhe heqjen e plumbçeve apo shenjave të bendosura gjatë periudhës së bllokimit.
  8. Në rast të konstatimit të dëmtimit të plumbçeve të vendosura nga autoritetet doganore, gjatë periudhës së bllokimit të aktivitetit, veprohet menjëherë sipas legjislacionit të akcizës dhe kodit penal.
  9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Degët Doganore, Departamenti i Akcizës në DPD, Drejtoria e Antikontrabandës dhe Drejtoria e Hetimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

